



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE BURIMEVE NJERËZORE

SHPALLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE Policia Bashkiake

PUNONJËS NË POLICINË E BASHKISË SË TIRANËS (POLICË DHE INSPEKTORË)

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr.8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe Komunës” (i ndryshuar), nenit 11 të Rregullores së brendshme “Tip” të policisë së bashkisë dhe komunës, VKM-së nr.525, datë 11.9.2018, “Për disa ndryshime në vendimin nr.313 datë 1.7.2002 të Këshillit të Ministartrave për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpezimeve buxhetore të policisë së bashkisë dhe komunës të ndryshuar”, Bashkia e Tiranës shpall procedurat e konkurimit për vendet e lira :

Polic në Policinë e Bashkisë së Tiranës (55 policë)
Inspektor në Policinë e Bashkisë së Tiranës (4 inspektorë)

Kandidatët për polic duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të kenë të kryer arsimin e mesëm;
- Të jetë i moshës nga 19-27 vjeç;
- Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht e mendërisht për të vepruar;
- Të ketë cilësi të larta morale e qytetare;
- Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim të formës së prerë;
- Preferohet të ketë punuar në policinë e shtetit dhe të mos ketë qënë i dënuar për shkelje të rënda dhe vepra penale;

Kandidatët për inspektor duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të kenë të kryer arsimin e lartë.
- Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht dhe mendërisht për të vepruar;
- Të ketë cilësi të larta morale e qytetare;

- Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim të formës së prerë;
- Preferohet të ketë punuar në policinë e shtetit dhe të mos ketë qenë i dënuar për shkelje të rënda dhe vepra penale;

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Kërkesë për aplikim (me shkrim dore);
- b- Curriculum Vitae
- c- Fotokopje e Kartës së Identitetit;
- d- Çertifikatë e përbërjes familjare;
- e- Librezë ushtarake ose vërtetim nga dega e mobilizimit ushtarak;
- f- Fotokopje e diplomës së shkollës dhe lista e notave e noterizuar;
- g- Çertifikata kualifikimi të ndryshme (në rast se ka);
- h- Fotokopje e librezës së punës.
- i- Motivacioni i largimit nga puna e fundit (në se është i punësuar ose ka qenë i punësuar);
- j- Raport mjeko-ligjor për ushtarakë;
- k- Vërtetim i gjendjes Gjyqësore;
- l- Vërtetim nga prokuroria (që nuk është aktualisht në proces hetimi)
- m- Vërtetim nga Gjykata (që nuk është aktualisht në proces gjyqësor)
- n- Vërtetim nga Drejtoria e Tatim-Taksave (që nuk është person fizik dhe juridik);
- p- 2 Fotografi (një copë 9 x 6 cm dhe një copë 2.5 x 3.5 cm).

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo në sportelet e Sektorit të Informimit dhe Shërbimeve për Qytetarët në Bashkinë e Tiranës brenda datës **26.10.2018**.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK TË DOKUMENTACIONIT

Në datën **31.10.2018**, Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Tiranës do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë Tiranë, në stendat e informimit të publikut dhe në stendat pranë Policisë Bashkiake, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet testimi. Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Tiranë. Afati i ankimit është **2 ditë** nga data e shpalljes së rezultateve të verifikimit.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë mbi ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”
- b- Njohuritë mbi ligjin nr.8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe Komunës” (i ndryshuar)
- c- Njohuritë mbi Rregulloren së Brendshme “Tip” të policisë së bashkisë dhe komunës.
- d- Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Kandidatët në testimin me shkrim dhe intervistën me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me punën;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për vlerësimi e kandidatëve është **100 pikë** i detajuar si më poshtë:

Vlerësimi maksimal për dokumentacionin është **25 pikë**

Vlerësimi maksimal për testimin me shkrim është **45 pikë**

Vlerësimi maksimal për intervistën me gojë është **30 pikë**

Kandidatët që marrin 60 % (27 pikë) të pikëve të testimit me shkrim, kanë të drejtë të vazhdojnë fazën e intervistës me gojë.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, (testimit me shkrim dhe intervistës me gojë) Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Tiranës do të shpallë fituesit në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të Bashkisë Tiranë në stendat e informimit të publikut dhe në stendat pranë Policisë Bashkiake. Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Tiranë. Afati i ankimimit është **5 ditë** nga data e shpalljes së rezultateve të testimit.